

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6799  
E mërkurë, 11 janar 2023  
çmimi 0.40

LDK-ja: Qeveria të japë  
s qarime në lidhje me 100  
milionë eurot ku u përfshinë  
Kurti e Berishaj | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE" AFARISTI BURIM PIRAJ | FAQE 8

## SYNIMI I FUSHATËS 'BESA-BESË', PRODHIMET E SERBISË TË MOS KENË VEND NË MARKETET E TROJEVE SHQIPTARE



Pronari i "Meka Halal Food",  
afaristi Burim Piraj, i cili është  
edhe ideator i fushatës "Besa-  
Besë" që ka për synim  
sensibilizimin e masës për  
konsumimin e prodhimeve  
vendore dhe bojkotimin e

produkteve që vijnë nga Serbia,  
ka theksuar se kjo fushatë është  
duke marrë hov dhe është  
optimist se shumë shpejt do të  
bëhet realitet misioni i kësaj  
kauze. "Synimi ynë është që së  
paku prodhimet finale serbe të

mos kenë vend në marketet e  
Republikës së Kosovës,  
Shqipërisë dhe të gjitha trojeve  
shqiptare", ka thënë Piraj, duke  
shtuar se ende zyrtarisht nga  
institucionet e vendit kjo fushatë  
nuk ka marrë mbështetje

### AKTUALE




NATO-ja DHE BE-ja ZOTOHEN PËR  
BASHKËPUNIM MË TË NGUSHTË | F. 2

DASH-I KRITIKON SULMIN E  
VUÇIQUIT NDAJ JOSEPHIT | F. 3

KMDLNJ-JA, RASHIQIT:  
A JE MINISTËR I KURTIT  
A PROKUROR I VUÇIQUIT? | F. 7

### EKONOMI



MË SHUMË SE 2.2 MILIONË  
MËRGIMTARË VIZITUAN  
KOSOVËN, SHPENZUAN RRETH  
1.5 MILIARD EURO | F. 8

### SPORT



ERMAL KRASNIQI NGA BALLKANI  
KALON TE CFR CLUJ | F.12

HAKIF BAJRAMI:  
SPECIALJA  
ËSHTË GJYKATË  
RACISTE, GJYKIMI  
I LIDERËVE TË  
UÇK-së DO TË  
JETË MARATONIK

FAQE 5



KRYETARËT E KOMUNAVE  
KËRKOJNË MBËSHTETJE MË TË  
FUQISHME NGA KRYEMINISTRI

FAQE 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mob: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
[info@kolegji.biznesi.com](mailto:info@kolegji.biznesi.com)  
030-500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# NATO-ja dhe BE-ja zotohen për bashkëpunim më të ngushtë

**BRUKSEL, 10 JANAR** - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, nënshkroi deklaratën e përbashkët për bashkëpunim strategjik me Bashkimin Evropian. Kjo deklaratë, që u nënshkrua të martën në selinë e aleancës në Bruksel, synon “ngritjen në një nivel më të lartë” të raporteve të këtyre dy institucioneve.

Deklarata u nënshkrua nga presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, dhe presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen.

Stoltenbergu tha se deklarata e tretë e NATO-s dhe BE-së për bashkëpunim strategjik është më e rëndësishme se kurrë më parë, duke pasur parasysh sfidat me të cilat përballet aleanca ushtarake perëndimore, veçmas pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës.

Shefi i NATO-s bëri thirrje që të ruhet uniteti i botës së lirë demokratike karshi kërcënimeve të Moskës.

“Presidenti [i Rusisë, Vladimir] Putin deshi ta pushtojë Ukrainën për disa ditë dhe të na ndajë ne. Në të dyja këto dështoi. Duhet të vazhdojmë ta forcojmë sigurinë euroatlantike dhe sigurinë e Evropës”, tha Stoltenberg.

Përveç Rusisë që ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt 2022, Stoltenbergu përmendi edhe Kinën si sfidë për sigurinë e përbashkët të NATO-s dhe BE-së.

Deklarata për bashkëpunim strategjik konfirmon rolin kyç të NATO-s si shtyllë e sigurisë kolektive euroatlantike, por edhe nevojën për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse të Bashkimit Evropian. Ky dokument kërkon më shumë bashkëpunim mes dy



institucioneve për t'u përballur me sfidat e reja, sulmet kibernetike, manipulimet informative, terrorizmin e deri te katastrofat natyrore.

Ndërkaq, presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, tha se NATO-ja dhe BE-ja janë rritur paralelisht dhe kanë plotësuar njëra-tjetrën përgjatë historisë.

Aktualisht, nga 27 shtetet anëtare të bllokut evropian, 21 janë anëtare të NATO-s. Ky numër pritet të arrijë në 23 pasi Finlanda dhe Suedia të hyjnë në aleancë. “Putini deshi më pak NATO, por e arriti të kundërtën. Tani kemi më shumë NATO dhe më shumë BE. Po e përshpejtojmë edhe procesin e zgjerimit drejt vendeve të Ballkanit Perëndimor”, tha Michel, duke

paralajmëruar më shumë investime në mbrojtjen dhe vazhdimin e mbështetjes për Ukrainën.

Pak pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës, Finlanda dhe Suedia vendosën t'i bashkohen NATO-s. Aktualisht, Turqia po mban të bllokuar procesin e anëtarësimit, duke kërkuar plotësimin e disa kushteve para ratifikimit të aplikimit për anëtarësim në aleancë të këtyre dy shteteve nordike. Edhe Hungaria ende nuk ka ratifikuar pranimin e këtyre dy shteteve në NATO.

Por, me hyrjen e Finlandës dhe Suedisë në aleancë, nën mbrojtjen e NATO-s do të jenë 96 për qind e qytetarëve të BE-së, tha Michel. Ai shtoi se NATO-ja do ta mbështesë edhe sigurinë e shteteve të bllokut që

nuk janë anëtare të aleancës.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se sfidat dhe kërcënimet e përbashkëta nuk vijnë vetëm nga Rusia. “Kërcënimi i Rusisë është më i afërmi, por jo i vetmi kërcënim për aleancën tonë. Duhet të kemi rezistencë edhe ndaj qëllimeve të Kinës që synojnë të vënë në dyshim sigurinë dhe stabilitetin tonë”, tha ajo.

Von der Leyen shtoi se në të ardhmen BE-ja dhe NATO-ja do të angazhohen në luftimin e ndërhyrjeve nga jashtë dhe manipulimeve të informacionit.

Ajo paralajmëroi se do të vazhdojë ndihma për Ukrainën dhe theksoi se blloku do të vendosë sanksione të reja ndaj Rusisë, por edhe ndaj Bjellorusisë,

aleates së Putinit, për rolin që ka në luftën kundër Ukrainës.

Presidentja e KE-së tha se duhet të rritet prodhimi i armatimit në vendet e bllokut dhe kjo, sipas saj, duhet të bëhet në bashkëpunim me NATO-n. Paralajmërim të ngjashëm bëri edhe Stoltenbergu, i cili tha se është e nevojshme të prodhohen armë dhe municione, për shkak se furnizimet me to janë pakësuar për shkak të ndihmës ushtarake për Ukrainën.

Liderët e dy institucioneve, po ashtu, kërkuar që Suedia dhe Finlanda sa më shpejt të bëhen anëtare të NATO-s.

Stoltenbergu u shpreh i bindur se Turqia dhe Hungaria do ta ratifikojnë anëtarësimin e dy shteteve nordike në aleancën ushtarake.

## Avokatët gjejnë dokumente të klasifikuara në ish-zyrën e Bidenit



**UASHINGTON, 10 JANAR** - Shtëpia e Bardhë më 9 janar e pranoi se avokatët e presidentit Joe Biden kishin gjetur “një numër të vogël” të dokumenteve të klasifikuara në ish-zyrën e tij në një institut kërkimor në Uashington vjeshtën e kaluar. Kjo ka nxitur një hetim të Departamentit amerikan të Drejtësisë, që mund të synojë të përcaktojë nëse duhet emëruar një këshilltar i posaçëm, si ai që hetonte keqpërdorimet e pretenduara të dokumenteve nga ish-presidenti

Donald Trump.

Dokumentet u zbuluan në Qendrën Penn Biden në fillim të nëntorit.

Bideni kishte hapur këtë institut pasi kishte përfunduar mandatin si nënpresident.

Shtëpia e Bardhë konfirmoi se është hapur një hetim dhe shtoi se do të bashkëpunojë me Departamentin e Drejtësisë dhe dokumentet i janë dorëzuar Administratës së Arkivave Kombëtare, agjenci që merret me të dhënat presidenciale.

Afërsisht janë gjetur 10 dokumenteve, tha një person që ka njohuri për këtë çështje, raporto i “Washington Post”. “Shtëpia e Bardhë po bashkëpunon me Arkivat Kombëtare dhe me Departamentin e Drejtësisë lidhur me zbulimin e atyre që duket se janë të dhëna të administratës Obama - Biden, përfshirë edhe një numër të vogël të dokumenteve të shënuara si të klasifikuara”, ka theksuar këshilltari i posaçëm i Bidenit.

FLET PËR "EPOKËN E RE", HAKIF BAJRAMI

# Specialja është gjykatë raciste, gjykimi i liderëve të UÇK-së do të jetë maratonik

Profesori i njohur i historisë, Hakif Bajrami, e ka quajtur raciste Gjykatën Speciale në të cilën janë duke u mbajtur në paraburgim liderët e UÇK-së. Bajrami ka thënë se kjo gjykatë nuk i përgjigjet as Kuvendit të Kosovës ani pse është themeluar nga ky institucion. Në këtë bisedë për "Epokën e re", Bajrami ka thënë se dënimi i Salih Mustafës me 26 vjet burgim është politik. Po ashtu, ai ka thënë se Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj janë dënuar dhe janë duke u mbajtur në Hagë pa pikë faji. Ndërsa sa i përket procesit gjyqësor ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit, i cili pritet të nisë së shpejti, ka thënë se do të jetë proces maratonik dhe shumë i vështirë

EPOKA ERE

Lirim GECI

Prishtinë, 10 janar - Profesor dr. Hakif Bajrami, i cili është një ndër historianët më të shquar shqiptarë, e ka quajtur rastiste Gjykatën Speciale. Bajrami në një bisedë për "Epokën e re" ka thënë se kjo gjykatë, edhe pse është themeluar nga Kuvendi i Kosovës, nuk i përgjigjet atij. "Gjykata Speciale është gjykatë raciste. Nuk ka askund në botë që një gjykatë e themeluar nga Kuvendi i Kosovës nuk i jep kurrfarë llogarie. Nuk ndodh askund në botë që të vijnë dokumentet në zyrë dhe të akuzohesh e dënohesh për to, siç është rasti i Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj. Pse nuk po e ngritin zërin edhe mediet për këtë çështje? Këta janë pa pikë faji atje", ka thënë Bajrami.

Sipas Bajramit, burimi i rrjedhjes së këtyre dokumenteve janë Gjykata Speciale dhe Serbia. "Këto dy burime janë, s'ka të tjera", është shprehur Bajrami. Bajrami ka kritikuar Policinë e EULEX-it edhe për trajtimin e Jakup Krasniqit në kohën kur është dërguar në Hagë. "Qysh

është sjellë Policia e EULEX-it ndaj Jakup Krasniqit dhe të tjerëve nuk është sjellë as policia e Jugosllavisë. Por, për çfarë është bërë kjo sjellje? Natyrisht për ta frikësuar popullin dhe për ta mbajtur gjithmonë Kosovën në majë të thikës dhe për të thënë se çështja e Kosovës nuk ka përfunduar. Unë them se çështja e Kosovës ka përfunduar më 17 shkurt 2008, atë minutë që është shpallur pavarësia. Para disa ditësh kam shkruar se gjithë duhet ta dinë se kur Ismail Qemali e ka shpallur pavarësinë më 28 nëntor 1912, s'ka pasur as ndërtesë të Kuvendit, as s'ka pasur ministri, as s'ka pasur banka, as s'ka pasur monedhë, as s'ka pasur gjyqe e as ligje dhe asgjë. Të gjitha këto janë bërë më vonë. Këtë e thashë për të treguar se ky popull di të ndërtojë shtet. Tash Kosova kur e ka Kuvendin, e ka Kushtetutën, i ka ligjet, e ka qeverinë, pra e ka të gjithë nomenklaturën që i duhet një shteti", ka thënë Bajrami.

Më tutje, Bajrami ka komentuar edhe dënimin e ish-komandantit të UÇK-së, Salih Mustafa, me 26 vjet burgim nga Gjykata Speciale. Ai ka thënë se



dënimi i Mustafës është politik dhe pa kurrfarë baze. "Salih Mustafa është dënuar në mënyrë arbitrare, politike dhe pa kurrfarë baze. Pra është dënuar për kinse e paska vuar një njeri dhe e paska rrahur një tjetër. 26 vjet burgim dhe nuk dihet kë e ka vuar. Kjo është absurde. A e dini se çfarë kanë bërë Arkani dhe Shajinoviqi dhe shumë të tjerë? Këtu te 'Grandi' i kanë bërë planet për vrasje dhe dhunimin e femrave shqiptare. Ndërkombëtarët i kanë ato materiale. I kemi edhe ne sepse janë në Arkivin e Kosovës. A janë dënuar ndonjëri? Jo asnjëri! Bile për Millosheviqin dikush thotë është gjallë, dikush ka vdekur,

mirëpo me ne është duke luajtur Evropa, amerikanët më jo, por edhe ata i kanë hesapet e veta. Shkojnë dhe e krahasojnë Kosovën me Ukrainën. S'ka lidhje ajo punë", ka thënë Bajrami. Ndërsa duke iu referuar procesit gjyqësor që pritet të fillojë së shpejti ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, profesor Bajrami ka thënë se ky proces do të jetë maratonik dhe shumë i vështirë. "Do të jetë gjykim maratonik dhe shumë i vështirë për faktin se janë shumë dokumente. Serbia ka investuar në këtë drejtim sidomos kur e ka parë që e ka humbur luftën. Të

gjitha bankat shtetërore të Serbisë janë në humbje sepse kanë paguar miliarda njerëz të shitur, besa edhe shqiptarë dhe ai shkon dhe thotë ma ka vuar këtë e atë dhe rrenë pa pikë marre. Serbia me kohë i ka tërhequr njerëzit e saj dhe janë të mbrojtur tashmë. Dhe sigurisht do të dëshmojnë", ka thënë Bajrami, duke shtuar se Serbia e ka humbur përgjithmonë Kosovën. "Serbia e di mirë se e ka humbur Kosovën përgjithmonë, por dëshiron ta mbajë të destabilizuar. Pse? Për arsye se në një vend që nuk është i sigurt askush nuk investon", është shprehur Bajrami.

## DASH-i kritikon sulmin e Vuçiqit ndaj Josephit

PRISHTINË, 10 JANAR - Nuk ka vend në shoqëritë demokratike për taktikat e njollosjes kundër qytetarëve sikurse ato që janë përdorur ndaj Edward Joseph, ka shkruar në "Twitter" Departamenti amerikan i Shtetit për Evropën dhe Azinë. Përveç këtij njoftimi, Joseph e publikoi edhe deklaratën, ku ai tha se presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka bërë akuza serioze dhe të pabaza ndaj tij gjatë një paraqitjeje të liderit serb në një televizion në Serbi më 30 dhjetor.

Departamenti amerikan i Shtetit shtoi se zërat e pavarur dhe organizatat e shoqërisë civile promovojnë llogaridhënien dhe transparencën. "Ne vlerësojmë ata që ndërtojnë shoqëri paqësore në Ballkanin



Perëndimor", ka theksuar DASH-i. Ky postim në "Twitter" u shoqërua me një fotografi të Josephit me ndihmësekretarin

amerikan të Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, Gabriel Escobar. Më 30 dhjetor, gjatë një paraqitjeje në televizionin "Prva",

Aleksandar Vuçiqi e quajti Edward Josephin "bastard. Vuçiqi, po ashtu, deklaroi për televizionin serb se ky ekspert i

Ballkanit merr "shumë para nga lobi shqiptar". Presidenti serb nuk ofroi dëshmi për këto pretendime.

Gjatë intervistës për REL-in, mes të tjerash, Joseph potencoi se sa i përket barrkadave të ngritura nga një grup i serbëve lokalë në veri të Kosovës, që bllokuan rrugët për pothuajse tri javë, Vuçiqi "po manipulonte Shtetet e Bashkuar dhe Bashkimin Evropian".

Ai, po ashtu, tha se qetësia në Kosovë, pas heqjes dorë nga barrkadat, do të zgjasë "deri kur Aleksandar Vuçiqi të vendosë se i duhet një krizë e re në Kosovë".

Pas akuzave të Vuçiqit, Josephi shkroi në "Twitter" se ato janë "krejtësisht të rreme" sa iu përket lidhjeve të pretenduara financiare mes tij dhe "lobit shqiptar".



MBAHET TAKIMI I TRETË KOORDINUES NË MES TË KRYEMINISTRIT ALBIN KURTI DHE KRYETARËVE TË KOMUNAVE

# Kryetarët e komunave kërkojnë mbështetje më të fuqishme nga kryeministri

Kryeministri Albin Kurti ka mbajtur të martën takimin e tretë koordinues me kryetarët e komunave, në të cilin është diskutuar për bashkëpunimin në mes nivelit qendror dhe atij lokal. Kryetari i Asociacionit të Komunave, Agim Aliu, në fjalën e tij ka theksuar se shpërndarja buxhetore për kategorinë e investimeve kapitale për komunat nuk është e barabartë dhe e drejtë. “Komunat e mëdha janë fare pak të përfshira në projektet kapitale të ministrive përkatëse, flas për projektet e reja të planifikuara në kuadër të buxhetit të vitit 2023”, ka thënë Aliu

**EPOKA E RE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 10 JANAR** - Kryeministri Albin Kurti ka mbajtur të martën takimin e tretë koordinues me kryetarët e komunave, në të cilin është diskutuar për bashkëpunimin në mes të nivelit qendror dhe atij lokal.

Kryeministri Kurti ka theksuar se në buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 për nivelin komunal ka një rritje të buxhetit prej 100 milionë eurove krahasuar me vitin paraprak. Kjo, siç tha kryeministri, duhet të reflektojë edhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve komunale karshi qytetarëve tanë, mirëqenies së tyre, edukimit, shëndetësisë, sportit, rinisë e kulturës dhe zhvillimit socio-

ekonomik. Kryeministri foli edhe për ndihmën dhënë qytetarëve dhe bizneseve, mbështetjen dhe nxitjen e prodhimit vendor në sektorin e bujqësisë, për arritjet në luftën kundër korrupsionit, aplikimin zyrtar për anëtarësim në Bashkim Evropian e shumë arritje të tjera.

Duke theksuar veprimet e ndërmarra nga qeveria për qytetarët nëpër komunat e Kosovës, kryeministri ka theksuar se bashkërisht, qeveria dhe komunat, do të duhej që përmes ekzekutimit të mirëfilltë të buxhetit 2023, ta lehtësojmë jetën e qytetarëve e ta zhvillojmë ekonominë e komunës e të vendit. “Qasja jonë si qeveri është që të jemi afër qytetarëve edhe duke qenë afër komunave

e për këtë na nevojitet shtim i bashkëpunimit mes institucioneve tona”, ka thënë ai. Si kryeministër i Republikës së Kosovës, Kurti ka theksuar se është i hapur e i gatshëm të jetë afër komunave, me gjithë kabinetin qeveritar, për t’u angazhuar bashkërisht për progresin demokratik, ekonomik e social të Republikës. Ndërkaq ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka folur për reformat ligjore në kuadër të agjendës legislative të MAPL-së, financimin e projekteve komunale me qëllim të zhvillimit ekonomik lokal dhe ofrimin e shërbimeve sa më kualitative për qytetarët duke u bazuar në digjitalizim dhe efikasitet. “MAPL-ja do të vazhdojë t’i mbështesë dhe bashkëpunojë me komunat për ta përmirësuar gjendjen socio-ekonomike të qytetarëve dhe për ta ngritur zhvillimin ekonomik lokal”, është shprehur Krasniqi. Kryetari i Asociacionit të Komunave, Agim Aliu, në fjalën e tij ka paraqitur kërkesat e kryetarëve të komunave në lidhje me qeverisjen lokale, të cilat ia kanë adresuar qeverisë dhe që nuk kanë marrë ende përgjigje. “Kemi kërkuar të dimë

arsyet e ndërprerjes apo anulimit të projekteve të caktuara. Deri më tani nuk kemi marrë përgjigje përfundimtare për shumë nga to. Gjithashtu, kemi kërkuar mbështetjen e qeverisë që të ndahet buxhet shtesë për komunat, që të përballohen kostot financiare si rrjedhojë e Kontratave Kolektive e të cilat paguhen nga buxhetet komunale. Edhe kjo nuk ka ndodhur, ndonëse jemi në dijeni të hapave të qeverisë për ndërprerjen e kontratave kolektive. Vazhdon të mbetet e përcaktueshme mundësia për themelimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, problematikë që, gjithashtu, e ngritëm në takimin e shtatorit. Sfidues dhe e rëndësishme jetike për qytetarët është edhe furnizimi me barna nga lista esenciale, përgjegjësi kjo e Ministrisë së Shëndetësisë, por që deri më tani jemi dëshmitarë që mbetet e pazgjidhur për të gjitha komunat”, ka thënë Aliu. Lidhur me buxhetin komunal ai është deklaruar se buxheti për komuna do të jetë rreth 660 milionë euro e që krahasimisht me vitet 2021 dhe 2020, shprehur në përqindje, rezultoi se ky buxhet aktual është më i vogël se në vitet e lartcekura.

“Konsideroj se është e padrejtë kur dihet se niveli lokal është porta e parë e çdo kërkesë qytetare. Kërkesat janë vazhdueshëm në rritje, andaj edhe qeveria duhet t’o shtojë buxhetet për komunat, duke ngritur substancialisht fondet për investimet kapitale dhe mallrat e shërbimet që të mundësohet përfshirja më e gjerë e kërkesave qytetare në planifikimet tona investive”, është shprehur Aliu.

Ai ka shtuar se shpërndarja buxhetore për kategorinë e investimeve kapitale për komunat nuk është e barabartë dhe e drejtë. “Komunat e mëdha janë fare pak të përfshira në projektet kapitale të ministrive përkatëse. Flas për projektet e reja të planifikuara në kuadër të buxhetit 2023. Ministrinë duhet ta planifikojnë barabarësisht shpërndarjen e fondeve publike përmes projekteve, duke përfshirë të gjithë komunat, gjykuar nga pesha, nevoja e rëndësia që paraqesin ato projekte për qytetarët e komunave përkatëse”, është shprehur ai.

Aliu përmendi edhe tentativën që mjetet buxhetore të pashpenzuar të komunave të kthehen mbrapsht si rishpërndarje. Sipas tij, kjo ishte

# LDK-ja: Qeveria të japë sqarime në lidhje me 100 milionë eurot ku u përfshinë Kurti e Berishaj

PRISHTINË, 10 JANAR - Zyrtarët e lartë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Xhafer Tahiri dhe Visar Azemi, kanë shprehur shqetësimin për paaftësinë e Qeverisë së Kosovës, konkretisht me rastin e mungesës së pasaportave si dhe aferën milionëshe ku janë të përfshirë kryeministri Albin Kurti dhe ambasadori Martin Berishaj. "LDK-ja është e shqetësuar me paaftësinë e kësaj qeverie që të ofrojë shërbime bazike për qytetarët e këtij vendi sikurse dokumente të udhëtimit. Janë bërë gati pesë muaj që qytetarët nuk kanë mundësi të nxjerrin pasaporta të reja, edhe në rastet kur u skadon afati i pasaportave aktuale. Liria e udhëtimit është një e drejtë bazike, nuk është luks. Ne kërkojmë liberalizim të vizave nga Bashkimi Evropian, ndërkohë shteti i udhëhequr nga Albin Kurti nuk ka aftësi që t'i pajisë qytetarët me pasaporta. Mungesa e aftësisë për planifikim të duhur ka bërë që të mos ketë materiale për shtypjen e këtij dokumenti të rëndësishëm", kanë theksuar zyrtarët e kësaj parti gjatë një konference për medie. Ata ka shtuar tutje se: "Shprehim

shqetësimin tonë për raportimin e medieve sllovene për afera milionëshe ku janë të përfshirë kryeministri Kurti dhe ambasadori i tij Martin Berishaj". Gazeta sllovene ka botuar një hulumtim të gjatë, ku hulumtohen lidhjet e ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishajt me kompaninë sllovene GEN. Sipas gazetës, dyshohet se ambasadori Berisha është paguar nga GEN-i, teksa raportohet edhe për kompaninë e Berishajt që mban emrin "MB Consulting". Madje aty theksohet se ambasadori kosovar ka tërhequr 600 mijë euro para të thata (cash) në vitet 2019 dhe 2020. "Në këtë hulumtim përmendet edhe kryeministri i Kosovës, Kurti, mbi të cilin hidhen dyshime se është financuar nga paratë e filialit të GEN-it në Tiranë, ku janë transferuar 14 milionë euro. Gazeta sllovene shkruan se dyshohet që paratë e GEN-it në Tiranë janë përdorur për ta financuar fushatën e Kurtit. Titulli i artikullit është 'Ndiqni paratë: Si GEN i Sllovenisë pagoi Martin Berishaj. Ku shkuan 100 milionë euro'. Gazeta raporton se nga këto 100 milionë euro, 60



milionë janë transferuar në Bosnjë dhe Hercegovinë, ndërsa miliona të tjera në filialin e GEN-it në Beograd e Tiranë. Ndërlidhja me kryeministrin

Kurti është pjesa më shqetësuese që besojmë se duhet të adresohet menjëherë. Prandaj kërkojmë që këto dyshime shqetësuese të

adresohen nga qeveria Kurti. A janë të vërteta deklaratimet e hulumtimit nga gazeta sllovene?", kanë deklaruar zyrtarët e LDK-së.



qasje e padrejtë e joligjore. "Tendenca e marrjes së të hyrave vetjake nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ishte e pakuptimtë për ne si autoritete lokale dhe ndoshta ende nuk është e qartë se çfarë do të ndodhë me bartjen e mjeteve nga të hyrat vetjake nga viti 2021, pra para vitit 2022. Ministër Murati, në ligjin për ndarje buxhetore për vitin 2023, thuhet se bilancet e

pashpenzuara të të hyrave vetjake të komunave nga viti fiskal 2022 të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK (Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës) si ndarje buxhetore për një komunë ndahen për vitin fiskal 2023 sipas autorizimeve të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike", ka bërë me dije Aliu, duke shtuar se komunat vazhdojnë të kenë problem me pronat e

administruara nga AKP-ja. "Këto tema, që sot u ngritën, u diskutuan dhe u ridiskutuan përsëri, janë vetëm disa nga shqetësimet që kanë komunat. 20 (njëzet) kolegjiunet e AKK-së që nga arsimi, shëndetësia, inspektorët komunalë, administrata dhe kolegjiunet e tjera që funksionojnë në kuadër të AKK-së kanë bregna. Na duhet bashkëpunim më i madh në mënyrë që të kemi një qeveri

lokale të fuqishme ashtu siç është e paraparë edhe në Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ashtu siç meritojnë qytetarët tanë. Mbesim me shpresë që çështjet dhe sfidat të cilat u ngritën sot nuk do të mbesin të pashqyrtuara. Asociacioni i Komunave të Kosovës është aleat e mbështetës i fuqishme i çdo reforme të ndërmarrë, natyrisht duke qenë bashkërisht realizator i saj, me përvojat që ka niveli lokal

dhe vendimmarrjen e mbështetjen që kërkohet nga niveli qendror", ka thënë ai. Kryetari i AKK-së thotë se mbesim me shpresën që kjo qasje e deritanishme e qeverisë të ndryshojë pozitivisht. "Presim që bashkërisht të punojmë për ta sendërtuar besimin e qytetarëve në vepra publike, në plotësim të kërkesave të tyre, në realizim të nevojave zhvillimore që kanë komunat tona", ka thënë Aliu.

## Kosova shënon ngritje për pesë vende sa i përket fuqisë ushtarake dhe njerëzore

PRISHTINË, 10 JANAR - Bazuar në matjet vjetore të GFP-së, rishikimit vjetor të indeksit të Fuqisë Globale Ushtarake 2023, në mesin e 145 shteteve, Kosova ka shënuar ngritje për pesë vende sa i përket fuqisë ushtarake dhe njerëzore. Kështu ka bërë me dije ministri i Mbrojtjes, Armend

Mehaj. “Në këtë studim është vlerësuar numri i ushtrisë, numri i pajisjeve ushtarake, niveli i financimit të sferës ushtarake, infrastruktura e transportit të vendit, qasja në produktet e naftës dhe faktorë të tjerë që mund të ndikojnë në aftësinë luftarake të ushtrisë”, ka shkruar Mehaj në

“Facebook”. Ai ka thënë se Ushtria e Republikës së Kosovës çdo vit e më shumë po ngrit kapacitetet profesionale dhe operacionale për të kontribuar jo vetëm në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit të vendit, por dhe në rajon e më gjerë.



## AAK-ja: Kushtetuesja i jep të drejtë nismës sonë për largimin e kushtit diskriminues ndaj pensionistëve kontributdhënës



PRISHTINË, 10 JANAR - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka mbajtur konferencë për medie lidhur me skemën pensionale dhe padrejtësitë që po u bëhen pensionistëve.

Deputeti Shemsedin Dreshaj ka thënë se është e pandershme që të punosh 14 vjet e 11 muaj para vitit 1999 dhe të llogaritet sikurse nuk ke dhënë kontribut fare. Ai ka thënë se kërkesa e AAK-së është të largohet ky kushtëzim, i dëmshëm dhe diskriminues për punëtorët e viteve '90. “Është e pandershme që të punosh 14 vjet e 11 muaj para vitit 1999 dhe të llogaritet sikurse nuk ke dhënë kontribut fare. Kërkesë jonë është të largohet ky kushtëzim jologjik, i dëmshëm

dhe diskriminues për punëtorët të cilët në vitet '90 ishin larguar dhunshëm dhe jashtëligjshëm nga institucionet shtetërore të pushtetit të atëhershëm. Njëkohësisht, kërkojmë që të respektohet periudha kohore maksimalisht prej 6 muaj e shprehur në këtë vendim nga ana e Gjykatës Kushtetuese dhënë Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e nenit 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim”, ka deklaruar Dreshaj para medieve.

## Arrestohen dy persona të përfshirë në dy raste të vjedhjes së veturave

GIJAKOVË, 10 JANAR - Drejtoria Rajonale e Policisë në Gjakovë, përkatësisht Stacioni Policor në Gjakovë, në kuadër të angazhimeve të vazhdueshme për parandalimin e dukurive negative, hetimin dhe arrestimin e të dyshuarve për përfshirje në vepra penale, pas një pune intensive operative dhe hetimore, ka arritur të identifikojë dhe të arrestojë dy të dyshuar të përfshirë në dy raste të vjedhjes së veturave. “Në dhjetor 2022 nga Stacioni Policor në Gjakovë janë iniciuar dy raste për vjedhje të veturave në qytetin e Gjakovës. Me datën 05.12.2022 ishte vjedhur vetura ‘Opel Corsa’, ndërsa me datën 22.12.2022 vetura ‘VW Golf’, raste të paraqitura nga pronarët e automjeteve. Me datën 07.01.2023 Stacioni Policor në Gjakovë ka arrestuar të dyshuarit: 1. A. L., banues në fshatin

Carrabreg-Deçan, i lindur në vitin 1992 (shtetas i Republikës së Kosovës) dhe 2. Sh. K., banues në fshatin Kishnarekë-Drenas, i lindur në vitin 1990 (shtetas i Republikës së Kosovës), mbi dyshimin se ishin të përfshirë në kryerjen e veprës penale ‘vjedhje’ në dy raste në fjalë. Në sajë të hetimeve të zhvilluar është arritur të gjenden dhe sekuestrohen edhe dy veturat e vjedhura”, ka njoftuar Policia e Kosovës. Sipas policisë, të gjitha veprimet hetimore të ndërmarra janë kryer në koordinim me Prokurorin e Shtetit, me vendimin e të cilit i dyshuari numër një është ndaluar në mbajtje dhe ndaj tij është iniciuar rast për vjedhjen e veturës, ndërsa ndaj të dyshuarit të dytë është iniciuar rast “Blerja, pranimit ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale”. Veturat e sekuestruara u janë kthyer ankuesve.



## Nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e teleferikut për në Kalanë e Prizrenit

PRIZREN, 10 JANAR - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, së bashku me ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu dhe agjencinë zvicerane “Swiss-Contact”, përfaqësuar nga Fisnik Reçica,

nënshkruan marrëveshje trepalëshe për ndërtimin e teleferikut për në Kalanë e Prizrenit. Ky projekt do të ndikojë në turizëm, rrjedhimisht në zhvillimin ekonomik të komunës së Prizrenit, në

kuadër të zhvillimit të produkteve turistike si një ndër atraksionet kyçe të komunës. Kalaja e Prizreni, përveç një margaritar i trashëgimisë kulturore, ofron një pamje të jashtëzakonshme të kryeqytetit historik të Kosovës.



# KMDLNj, Nenad Rashiqit: A je ministër i Kurtit a prokuror i Vuçiqit?

## Reagim i KMDLNj-së

Azem Kurtaj, pjesëtar i FSK-së, është arrestuar nën dyshim se ka plagosur dy fëmijë serbë, njërin 21-vjeçar dhe tjetrin 11-vjeçar në komunën e Shtërcës. Pas ndalimit policor prej 48 orëve, Gjykata Themelore në Ferizaj, me propozim të prokurorit të rastit ia caktoi masën e arrestit prej një muaji. Në ndërkohë, serbët bllokuan rrugët të cilat pastaj u ç'bllokuan dhe, në organizimin e Listës Serbe u organizua një protestë në Shtërcë ku morën pjesë një numër i konsiderueshëm i qytetarëve serbë të kësaj komune. Menjëherë pasi ndodhi rasti KMDLNj, në me një deklaratë publike kërkoi që rasti të mos paragjykohej, të pritet përfundimi i hetimeve dhe të mos dhunohet parimi i prezumimit të pafajësisë që është standard ndërkombëtar në fushën e drejtësisë si parakusht për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të pandikueshëm politikisht, si njëra ndër vlerat elementare të të drejtave të njeriut edhe për personat e privuar nga liria. Ky standard u dhunua pikërisht nga ata që duhet të jepnin shembull por që e kanë edhe detyrim kushtetues të mos ndërhyjnë në procesin e hetimeve, presidentja,

kryeministri, ministra, shefa të grupeve parlamentare e kush jo tjetër. Ndërkombëtarët, sidomos kur janë serbët në pyetje reagues si kor, njëzëri dhe me cilësime më të rënda, pa filluar ende hetimet. Reagimi i tyre në këto raste është refleksiv dhe automatik. Reagoi edhe kisha ortodokse e Serbisë, të gjithë udhëheqësit më të lartë të Serbisë dhe disa analistë të ricikluar për çdo situatë dhe për çdo përdorim në Kosovë si dhe pjesa llaskuce e shoqërisë civile. Nuk mbahet mend që të ketë pasur aq shumë reagime kundër një të arrestuari dhe aq linçime publike sa ndaj të arrestuarit Azem Kurtaj dhe të ketë pasur garë se kush do të bëjë cilësime më të rënda, më fajësuese dhe më paragjyquese, në të njëjtën kohë. Këto ishin qartë porosi për prokurorin e rastit dhe Gjykatën Themelore në Ferizaj se çfarë vendimi duhej të merrej dhe se çdo vendim që do të ishte në kundërshtim me cilësimet e skuadrës për pushkatim publik, pa i bërë asnjë gjykim të arrestuarit Azem Kurtaj, do të kthehej kundër prokurorit të rastit dhe Gjykatës Themelore në Ferizaj. Në këto raste a Baba Vanga nuk do të kishte guxim të merrte vendim tjetër përveç masës së arrestit. Pra, as që mund të flitet se ndaj të privuarit Kurtaj janë zbatuar standardet minimale ndërkombëtare për personat e



privuar nga liria dhe se e tërë rrjedha e deritashme është në kundërshtim të plotë me vendimet e Gjykatës për të Drejtat e Njeriut në Strasburg për raste të ngjashme dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. KMDLNj ua përkujton opinionit dhe linçuesve se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka marrë vendime në favor të të arrestuarve dhe të dënuarve kur ata janë privuar nga liria nën presion të opinionit publik e rasti Kurtaj është i tillë ku presioni dhe deklaratat publike ua zënë vendin argumenteve dhe ku gjykimi bëhet thjesht një formalitet. Përgjegjësi për krime lufte në Kosovë, Velko Odallovij deklaroi se Danush Kurtaj, i ekzekutuar

në Burgun e Dubravës nga paramilitarët serbë në vitin 1999, babai i Azem Kurtajt paska qenë terrorist. Askush nga institucionet zhurmëbërëse në Kosovë nuk reagoi për këtë cilësim e ishin aq të zhurmshëm në gjykimin e Azem Kurtajt, ende pa filluar hetimet. Këto janë standarde të dyfishta që po zbatohen në Kosovë, mësim i mësuar nga ndërkombëtarët, për qëllime politike. Nenad Rashiq që veten e shet si zë i arsyeshëm i serbëve të Kosovës dhe së voni u bë ministër në qeverinë Kurti 2, në një intervistë medias "Nova - RS", pa asnjë mëdyshje dhe pa patur fare prova deklaroi se Azem Kurtaj me qëllim ka gjuajtur drejtë serbëve, jo për t'i frikësuar ata, por për t'i varur. Mbulesë për këtë e kishte cilësimin e prokurorit të rastit si dhe vendimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj si dhe bisedimet me ministrin Sveçla. Pastaj, si fakt përdori edhe deklaratat dënuese të politikanëve të Kosovës dhe reagimet joqeveritare. Përtej këtij cilësimi, Nenad Rashiq kërkoi që Azem Kurtaj t'i zgjerohen hetimet duke marrë deklaratat nga kolegët e të arrestuarit (në FSK) për qëndrimet nacionaliste të Azem Kurtajt në FSK. Nenad Rashiq paraqitet edhe më i skajshëm se Goran Rakiq ndonëse i maskuar me një cipë të lojalitetit ndaj institucioneve të Kosovës. Nenad Rashiq, me cilësimin paragjyques të Azem Kurtajt si vrasës, pa një vendim të formës së prerë të një gjykate përkatëse, ndërhyjnë në mënyrë flagrante në punën e gjyqësorit nga një

pozitë e fuqishme politike e të qenit ministër ndonëse duhet ta ketë të qartë se pushtetet janë të ndara. Nenad Rashiq aspak dhe me asgjë nuk dallon nga Velko Odallovij, madje, për më keq, për këto ndërhyrje të paargumentuara në një procedurë gjyqësore, ai paguhet me një pagë të majme të taksapaguesve kosovarë në mesin e të cilave janë edhe taksat e Azem Kurtajt i cili, në vend që të ketë një proces gjyqësor të drejtë, ai po dënohet paraprakisht përmes linçimit publik e që Nenad Rashiq, nga pozita e pushtetit dhe të urrejtjes po bën përpjekje t'i shqiptojë dënimin, pa një proces gjyqësor, arbitrarisht dhe padrejtësisht. Në një vend normal, ky farë ministri do të duhej të shkarkohej me urgjencë, pa i dhënë as mundësinë më të vogël për të dhënë dorëheqje. Po Nenad Rashiq, as nuk do të shkarkohet e lëre më të jep dorëheqje sepse në Kosovë kanë vdekur përgjegjësia institucionale dhe përgjegjësia morale. KMDLNj nuk e paragjykon rastin e Azem Kurtajt, as duke e deklaruar pafajësinë e tij apo duke e shpallur fajtor për faktin se kjo është përgjegjësi ekskluzive e gjykatës përkatëse mirëpo kërkoi nga linçuesit e deklaruar dhe ata që mund të paraqiten në të ardhmen që të mos ndërhyjnë në procesin gjyqësor, të presin përfundimin e hetimeve, të presin vendimin e formës së prerë të gjykatës dhe të respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë, si vlerë dhe e drejtë e njeriut të personave të privuar nga liria.



## Krasniqi pret në takim kryetarin e Aleancës për Shqiptarët, Arben Taravari

PRISHTINË, 10 JANAR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur në takim kryetarin e Aleancës për Shqiptarët, Arben Taravari, njëherësh kryetar i komunës së Gostivarit.

Në këtë takim Krasniqi dhe Taravari kanë diskutuar për gjendjen aktuale politike, për zhvillimet në Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut si dhe për rolin e faktorit politik shqiptar atje. "Folëm edhe për planet dhe objektivat që mëtojmë t'i

përmbushim përgjatë këtij viti si dhe për thellimin e bashkëpunimit mes dy partive dhe dy vendeve. PDK-ja mbetet përherë e përkushtuar për kultivimin e raporteve tona të mira vëllazërore", ka thënë Krasniqi pas takimit.



FLET PËR “EPOKËN E RE” AFARISTI BURIM PIRAJ

# Synimi i fushatës ‘Besa-Besë’, prodhimet e Serbisë të mos kenë vend në marketet e trojeve shqiptare

Pronari i “Meka Halal Food”, afaristi Burim Piraj, i cili është edhe ideator i fushatës “Besa-Besë” që ka për synim sensibilizimin e masës për konsumimin e prodhimeve vendore dhe bojkotimin e produkteve që vijnë nga Serbia, ka theksuar se kjo fushatë është duke marrë hov dhe është optimist se shumë shpejt do të bëhet realitet misioni i kësaj kauze. “Synimi ynë është që së paku prodhimet finale serbe të mos kenë vend në marketet e Republikës së Kosovës, Shqipërisë dhe të gjitha trojeve shqiptare”, ka thënë Piraj, duke shtuar se ende zyrtarisht nga institucionet e vendit kjo fushatë nuk ka marrë mbështetje

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 JANAR -

“Epoka e re”: Z. Piraj, jeni ideator i fushatës sensibilizuese “Besa-Besë”. Sa anëtarë keni deri më tani?

**Piraj:** Grupi “Besa-Besë” ka pasur anëtarësi virtuale, ndërsa sot ka një këshill drejtues prej 15 anëtarëve i cili harton strategjinë. Anëtarët e këshillit bëjnë punë praktike në terren dhe në grupin virtual #mosbliprodhimeserbe i ka 103 mijë anëtarë.

“Epoka e re”: Si është duke ecur fushata dhe sa janë përmbushur pritjet tuaja?

**Piraj:** Më 24 janar 2023 bëhen 15 muaj punë e palodhur e grupit për t’i vetëdijesuar qytetarët për të mos blerë prodhime serbe. Ashtu siç kemi pritur, fushata ka filluar t’i japë

frutat e veta. Nga Dogana e Kosovës ka pasur deklaratë se ‘produktet serbe’ në Kosovë janë në rënie dhe gjithashtu një prej të arriturave tona të mëdha është fillimi i largimit të prodhimeve serbe nga disa dyqane dhe qendra tregtare. Kur e kemi filluar fushatën kemi qenë të mendimit se ndoshta do të na duhen pesë vjet punë për t’i vetëdijesuar qytetarët për të mos blerë prodhime serbe, mirëpo hovi që ka marrë fushata na bën të jemi optimistë se shumë më shpejt do të bëhet realitet misioni i kauzës sonë.

“Epoka e re”: Ndërkohë që ka një sensibilizim të madh të masës për bojkotim të produkteve serbe, sa keni marrë mbështetje nga spektri politik deri më tani?

**Piraj:** Nuk do të thotë se politikanët individualisht nuk e



përkrahin fushatën tonë, mirëpo zyrtarisht nuk kemi përkrahje. Duhet theksuar se edhe nga RTK-ja nuk kemi asnjë përkrahje, njëjtë si RTS. Bile kemi pasur rast të jemi edhe në mediet serbe kur i kemi publikuar fotot e deputetëve duke u shërbyer me ujë serb, por nga RTK-ja kurrë.

“Epoka e re”: Cili është synimi juaj me anë të kësaj fushate?

**Piraj:** Është e kuptueshme që importet nga Serbia nuk mund

t’i sjellim në zero, por synimi ynë është që së paku prodhimet finale serbe të mos kenë vend në marketet e Republikës së Kosovës, Shqipërisë dhe të gjitha trojeve shqiptare. Kur niveli i importeve nga Serbia të bie nën 50 milionë gjatë vitit, ne do të konsiderojmë se fushata jonë ka dhënë rezultat, por edhe atëherë nuk do të ndalemi. Duhet të vazhdojë vetëdijesimi i qytetarëve, sepse ne shumë shpejt harrojmë.

“Epoka e re”: A keni marrë ndonjë reagim nga Serbia ndaj kësaj fushate?

**Piraj:** Kemi pasur padi nga shoqëria civile serbe në Kosovë dhe nga një parti politike serbe, gjithashtu në veri të Kosovës. Fushata jonë ka prodhuar një kundërfushatë, ku ata bëjnë thirrje të konsumohen produkte të vendeve që s’e kanë njohur Kosovën. Jemi të sigurt se në këtë fushatë si në çdo aktivitet që bëjnë serbët e Kosovës ka gisht Beogradi zyrtar.


## Më shumë se 2.2 milionë mërgimtarë vizituan Kosovën, shpenzuan rreth 1.5 miliard euro

PRISHTINË, 10 JANAR - Një numër i madh i mërgimtarëve kanë vizituar Kosovën gjatë vitit që lamë pas. Numri i përgjithshëm i bashkatdhetarëve që kanë vizituar vendin gjatë vitit 2022 është 2 milionë e 274 mijë apo mbi 220 mijë më shumë se në vitin 2021. Megjithatë, numri i bashkatdhetarëve që kanë ardhur për festa të fundvitit është më i ulët për mbi 160 mijë krahasuar me dhjetorin e vitit 2021.

Zëvendësministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Liza Gashi, ka thënë se barrikatad rrugore për dy tri ditë në Serbi dhe inflacioni mund të kenë ndikuar në rënien e numrit të

bashkatdhetarëve për këtë fundvit.

Përveç remitancave gjatë vitit 2022, sipas raportit të BQK-së, bashkatdhetarët kanë shpenzuar mbi 1.48 miliard euro gjatë vizitave në Kosovë. “Nëse i shohim këto statistika dhjetor 2021 dhe dhjetor 2022, deri më 28 dhjetor 2022 shihet se ka një ulje të numrit të bashkatdhetarëve që kanë ardhur krahasuar me dhjetorin e vitit paraprak. Kjo rënie ka disa shkaqe, e para për shkak të krizës ekonomike dhe inflacionit, e dyta pengesat potenciale rrugore që kanë mundur t’u shkaktohen bashkatdhetarëve tanë. Në këtë drejtim, si total, dallimi



mes vitit 2021 dhe 2022, është se këtë vit ka pasur më shumë hyrje sesa në vitin paraprak. Në vitin 2021 kemi pasur rreth 2 milionë e 50 mijë qytetarë,

ndërsa në vitin 2022 kanë qenë 2.2 milionë”, ka thënë Gashi për “KosovaPress”. Gashi ka thënë se prioritet për qeverinë mbetet edhe

diplomacia ekonomike për promovim dhe nxitje të investimeve të huaja në Kosovë. Ajo ka bërë me dije se gjatë vitit 2023 pritet të emërohen rreth dhjetë ambasadorë ekonomikë. “Presim që në vitin e parë të kemi rreth 10 ambasadorë ekonomikë të specializuar në kuadër të rrugëtimit, misioneve tona diplomatike, shtu kësaj edhe 42 diplomatë të ngarkuar me punë në kuadër të misioneve që kanë portofolin e diplomacisë ekonomike. Këtu do të jemi më ‘agresivë’ në vitin 2023 sa i përket prezantimit të këtij potenciali përmes forumeve, marrëveshjeve të bashkëpunimit bilaterale për tregti”, ka thënë Gashi.



Bisedë me Kadri Halimin (2)

# Idealistët nuk marrin parasysh asnjë vështirësi

*Në shtëpinë e Kadri Halimit, në prani të bashkëshortes, bisedojmë për jetën e tij, që nga lindja e deri më sot*

*Më xhelat nga shqiptarët asokohe, kush ishte?*

– Shqiptarë xhelat nuk ka pasur. Serbët i bënin të gjitha të zezat.

*Kush u printe serbëve?*

– Vllada Popoviçi. I biri i Tomë Popoviçit. Ai i ka bërë këto masakra në Gjilan. Vetëm ai.

*Fjalimin tuaj në ballkon, aty, si e pritën shkiët?*

– S'kam folur shumë, nja dy tri fjali. Nja dy net, nuk kam guxua të fle në shtëpi. Me gjithë shoqen time kam ndenjtur në Këshillin e Rrethit. Unë po të them me bindje se shqiptarët nuk kanë hyrë në parti për t'u bërë komunistë, por kanë hyrë për çështjen kombëtare dhe për bashkim me Shqipëri.

*Sa keni qëndruar në detyrën e sekretarit aty në Gjilan?*

– Aty, në atë detyrë, kam qëndruar prej nëntorit deri në mars. Nja tre muaj. Ajo OZN-a mbajti mbledhje në Bashki. Ai i OZN-ës ishte Lubo Shotra, dhe u çua në mbledhje e për mua tha serbisht: da se smeni (të ndërrohet) Kadri Halimi.

*Me çfarë arsytimi?*

– Kinse nuk ke qenë aktiv. Nuk po i ndjek ballistët dhe bile ka lidhje me ta. Në realitet ashtu ishte.

*Kush u tregonte ashtu?*

– Po, shqiptarët, po kush tjetër? Për mua thoshin koketon me ballistë. Punoja në komandën e vendit hala. Halili ishte komisar. Unë isha nëpunës. Komandant ka qenë një shka. Atëherë patën ardhur nga internimi Kurtesh Agushi e Sinan Hasani, që kanë qenë të internuar në Vjenë. Në vendin tim u emërua Sinan Hasani. Prej atëherë, ai gjithmonë ka qenë në pushtet dhe ka shkuar përpara.

*Gjatë asaj kohe, sa ishit sekretar, a ka pasur arrestime?*

– Po, vazhdimisht. Vrasjet u ndalën, por vazhduan gjykimet dhe dënimet. Flitet për tortura të rënda gjatë atyre hetimeve nëpër të cilat kalonin njerëzit që arrestoheshin. Ka pasur edhe tortura me zjarr. I kanë rrahur njerëzit, i kanë torturuar dhe, duke i therur me thika, i kanë dërguar për pushkatim.

*Çka u bë me atë celulën tuaj të partisë komuniste?*

– Interessant është se në Gjilan asnjë prej atyre shokëve nuk pati mbetur. Kam mbetur vetëm unë. Të gjithë të tjerët ishin

larguar. As Veseli, as Vebia, as Kurteshi, vetëm unë kam mbetur. Qysh kam shpëtuar, nuk e di as vetë. Në të '46-tën, e pashë që nuk ka rehati, vendosa të shkoja në studime, mbasi me përjashtuan. Pata ardhur në Prishtinë dhe pata punuar nja motmot a ma shumë. Nga Këshilli Krahinor shkova në Prizren, prej Prizrenit u ktheva në Prishtinë. Mora pushim vjetor dhe shkova në studime dhe u regjistrova në fakultet në të '46-tën.

*Ku?*

– Në Beograd. Regjistrova grupin e pestë – shkencat etnologjike. Dhe kam diplomuar me sukses të shkëlqyeshëm në vitin 1950, për katër vjet.

*A ju kujtohet dikush nga studentët, kush ishte më aktiv, që eksponohej në pikëpamje kombëtare?*

– Ka qenë Aliu dhe unë, të tjerë nuk kam njohur. Kanë qenë edhe Ramadan Vraniçi, Fran Berisha, Talat Gorani...

*Në çfarë moshe u martuat?*

– Jam martuar në vitin 1943. U martova me një vajzë nga qyteti, vendëse e qytetit. Nga familja e Mulla Sherifit. Ajo ka pasur disa djem të vëllezërve, ndërsa vëllezërit i kanë vdekur.

*Sa fëmijë i keni?*

– Katër, dy vajza e dy djem. Drita është fëmija im i parë, tash e njohur si Drita Statovci. Ajo i ka tri vajza. Ajo ka mbaruar fakultetin e gjeografisë. Edhe ajo është orientuar në etnologji dhe akoma merret me këtë fushë studimesh. Punon në Institutin Albanologjik. Emrat e vajzave të saj janë: Anila, Brikena dhe Ardita. Fëmija i dytë është Enveri. Ky i ka tre djem. Emrat e tyre janë Partim, Krenar, Besart. Fëmija im i tretë është vajza ime, Zojë Halimi. E martuar për Fatmir Bujupin (shahisti i njohur). Është mjeke e sëmundjeve të krahavorit. Ka një çikë e një djalë. Çika e ka emrin Flakë e djali Festim. Fëmija im i katërt është djali im, Andini. Ka pas regjistruar kiminë. Në vitin 1990 e zuri lufta në Kroaci, në Karlovac. Prej aty e kanë transferuar në Shabac. Aty kemi shkuar unë e gruaja, e kemi marrë. Iku nga ushtria. Ka ndenjtur nja gjashtë vjet në Gjermani. Pastaj ka ardhur në shtëpi dhe punon këtu. Është i martuar. Ka dy djem. Shnatronin dhe Erionin.



*Kur ishit në studime, a keni pasur ndonjë fëmijë?*

– Po, i kam pasur dy; Dritën dhe Enverin. Djali ka lindur kur isha në Beograd. Shoqja e ka emrin Kadrije e unë Kadri. Kam banuar me grua atje. Dikur u bëra asistent dhe më dhanë një banesë. Më ndalën menjëherë për asistent. Në bazë të suksesit, njëherë më pranuan profesor e pastaj ato formalitetet për asistent në vazhdim. Shefi i katedrës ishte Drobnjaković Borivoje, dhe shpeshherë me thoshte se serbët po ia shohin për të madhe që ka pranuar këtë shqiptar asistent e nuk ka marrë një serb prej këtu. Fakultetin e kam mbaruar në moshën 27-8 vjeçare.

*A ju kanë ndjekur gjatë studimeve, pasi ishit i përjashtuar edhe i burgosur?*

– Po, sigurisht. Dhe e kam ditur. Ka qenë një Manetović nga Prizreni. Më kanë burgosur në vitin 1952. Si Informbyroist, kishe për Stalinin.

Ka qenë një Rista Vučković, ai ma sjell mua do material propagandistik. Kur unë po dua t'ia kthej, atë Riston e kishin pas futur brenda.

E kam takuar në Goli Otok. Kur më ka parë atje, ka menduar që unë e kam qitur në kurth për atë libër. Aty ishte në burg edhe Vehbi Rexhepi. Aty u bë një rrëmujë dhe nuk dihej kush çka po bën. Ai materiali që ma pat dhënë ishte Projekti i Çubrilloviçit që e kishte lexuar para Shoqatës kulturore serbe.

*Ju, baca Kadri, a ju kanë marrë në pyetje gjatë asaj kohe?*

– Po, përherë.

*Gjatë qëndrimit tuaj në burg, a*

*keni pasur kontakte, a jeni parë mes vete?*

– Po, more, jemi parë, pasi kemi qenë në një pavijon. Por, jemi ruajtur shumë. Kur ishim shumë veta, mundeshim të flisnim. Kur kemi dalë të punojmë mbi 200 veta kolektivisht, krejt kemi mundur të kontaktonim.

*Hetimet, kur i bënin, kur ju merrnin në pyetje? Pas punës, natën, apo?*

– Ka qenë aty në burg edhe vëllai i Josip Gjergjës, i cili kishte qenë kryetar i një komune a nuk di, ashtu diçka, ishte në burg. Ka qenë një malazez, Savo Raguzh, dhe më thirrën mua atje. Më thanë, ti je me fakultet, sigurisht nënën e ke pa shkollë. A ke baba? Jo, më ka vdekur, Po, nëna? Sigurisht. Profesoreshë, a? Si e ka emrin? Nuk më binte ndër mend emri i nënës! Ti po do ta fshehësh emrin e nënës a? Kur një tjetër po thotë, mos e ngucni djalin se boll. A po e sheh që ky qenka hutuar krejt. Nuk po e di as emrin e nënës së tij. Ai tjetri po thotë, nuk po do ta tregojë atë. Kur, dikur, na e prunë atë të Zarës. Ai po ma këndon këngën "Oj e bukura More". Mbas 6 muajsh më ra ndër mend emri i nënës dhe shkova e u thashë se më ka rënë ndër mend emri i nënës. Ai i Zarës ka qenë i burgosur aty. Kishte qenë kryetar komune. Ai farë Gjergja, thonë e ka gjetur atë ishullin e Goli Otokut.

*A keni bartur gurë aty, siç thonë?*

– Po. Gjatë gjithë kohës sa kam qëndruar aty, kam punuar në gurore. Herë me caktonin me vagoneta të punoja. Me ato vagoneta i bartnim gurët. Ka qenë edhe vendi ku i

përpunonin ata gurët.

Qeshë pjekur nga rrezatimi, qeshë nxirë e rreshkur krejt, sa nuk mund të më njihnin as njerëzit e familjes. Kur jam kthyer në shtëpi, nëna thoshte, ma kanë ndërruar djalin shkiet, nuk është ky djali im.

Ka qenë një Abit Qollaku i Prizrenit, një moment e kishin organizuar linçimin e tij, e shoh kur e kanë qitur aty, e kanë filluar ta rrihnin me çdo gjë, shkelma, dru, e grushte. Gjaku i shkonte vadë. U alivanos. E morën, e dërguan diku, por mbasandaj e kam parë që u kthye gjallë.

Ka pasur shqiptarë të Tetovës. Ne patëm mbetur tre veta të Kosovës me çekanë. Mua më thirri hetuesi e po më thotë, kur do të mbushesh mend? Përherë flet diçka pa lidhje. Ai po më thotë se nuk do të dalësh gjallë prej këtu. Ky që e dëgjonte po thotë, kjo është metodë e tyre. Ti do të dalësh gjallë prej këtu. Ata e bënin këtë për të frikësuar njerëzit që të mos bënin vepra të tjera e për t'u kthyer këtu prapë. Për burgosjen e dytë, kam shkruar në letër. Më patën dënuar shtatë vjet e gjysmë. Me akuzë për veprimtari armiqësore. Bashkim kundër shtetit dhe bashkimin e të gjitha viseve shqiptare, që ishin nën Jugosllavi me Shqipërinë. Aliun e dënuan tetë vjet, e mua 7,5, ndërsa Ramadanin tetë vjet burg. Këta patën ikur.

*Sa ishte zhgënjimi juaj në jetë për ato ideale që luftuat, sa tragjedi e sa drama keni përjetuar dhe në fund u tradhtuat?*

– Ata e kishin pasur në plan për të na shfarosur krejt. Kallëzomëni ju, si po shkon

puna tash?  
Idealistët nuk marrin parasysh asnjë vështirësi. Ata nuk synojnë kurrfarë pasurie, as dekorata as privilegje. Atyre u intereson liria. Tash një pjesë e atij ideali është realizuar. Nesër të shkojmë në Drenicë dhe t'i nderojmë të rënë, por edhe t'i pyesim se çfarë kanë përjetuar, kjo duket pak përtej realitetit. Unë e njoh Fehmi Lladrovcin, si ka thënë ai. Si ka rënë për liri. Ai ka shkuar në luftë i gatshëm për të vdekur.

*Baca Kadri, a mund të na thoni diçka për arrestimin tuaj, ndonjë çast dramatik? A lexonit diçka aty në burg?*  
– Kam harruar! S'na kanë lënë asgjë as kur ishim jashtë burgut e le më në burg.

*Për etnologji diçka?*  
– Jo.

*A lexonit shtypin?*  
– Po, shtypin serb.

*A keni pasur shokë dhe a keni biseduar me ta gjatë qëndrimit tuaj në burg?*  
– Po, sigurisht.

*A ju kujtohet emri i ndonjërit, dikush prej tyre?*  
– Jo, i kam harruar krejt.

*Ndonjë shok më të mirin?*  
– Aliun e kam pasur.

*A keni pasur provokime nga gardianët apo drejtoria e burgut?*  
– Po, sigurisht se kemi pasur. Na kanë detyruar të punojmë punë të rënda.

*Çka keni punuar?*  
– Atje ku mbaronin vaska metali. Punonim në furra. Ishte zhurmë e madhe. Punonim me veshë të mbyllur.

*Keni punuar me ndërrime?*  
– Po, sigurisht. Punonim me tri ndërrime.

*Gjithë kohën keni punuar aty?*  
– Po. Sa kohë që kam qenë në Nish, aty kam punuar.

*Sa vjeçar ishit kur keni vuajtur dënimin në Nish? Sa ju kanë mbajtur në Nish?*  
– Pak. Prej aty na kanë shpërndarë nëpër burgjet e tjera. Mua më dërguan në Stara Gradishkë. Vëllanë tim e dërguan në Bosnjë. Aliun e mbajtën në Nish.

*Po në Stara Gradishkë?*  
– Aty një vit kam vuajtur në vetmi. Pastaj në pavijon.

*A lexonit diçka aty?*  
– Po. Ka pasur edhe libra, bibliotekë.

*Në ç'orë ju zgjonin?*  
– Në orën shtatë.

*Sa kohë kishit shëtitje?*  
– Gjysmë ore. Nga ora tetë ose nëntë.

*Keni pasur shtrat në qeli?*  
– Po.

*Ishit me dikë apo vetëm?*  
– Fill vetëm. Edhe në shëtitje vetëm. Pasi më kanë hequr nga vetmia, më kanë bashkuar me të burgosurit e tjerë, por nuk ka pasur shqiptarë.

*Pasi ju hoqën nga qelia, a ju dërguan në punë?*  
– Po. Kam punuar atje ku punoheshin cisternat. Kemi pasur syze gjithmonë, sepse aty kishte saldime gjithë kohën.

*Edhe kur punonit, nuk ju jepnin ushqim më të mirë?*  
– Jo. Sikur të gjithë të burgosurve.

*Sa kohë keni punuar në atë uzinë?*  
– Dy-tre vjet po.

*Keni qenë të sëmurë ndonjëherë?*  
– Jo.

*Dhomat e fjetjes, me shokë?*  
– Po, kanë qenë dhoma të mëdha ku flininim nga dhjetë e pesëmbëdhjetë veta. Edhe në vazhdim kanë bërë transferime. Mua më kanë kthyer prapë në Serbi. Dikë e kanë dërguar në Slloveni apo Kroaci. Mua më dërguan në Pozharevc.

*A ishte burgu më i mirë se në Nish?*  
– Po. Më i mirë se në Nish.

*Po a takuat ndonjë shqiptar në Pozharevc?*  
– Po. Por në vitin 1966, kur ra Rankoviçiqi, e zbutën pak trajtimin, por fare pak.

*Ju kanë mbajtur në dhoma kalimtare?*  
– Jo.

*Sa ju kanë mbajtur nën hetime herën e parë?*  
– Jam burgosur dhe kam vuajtur në Beograd, gjashtë muaj nën hetime.  
*Po herën e dytë?*

– Prej muajit mars deri në shtator, nën hetime, më kanë mbajtur në burgun e Prishtinës.

*A keni pasur tortura në burgun hetues?*  
– Ka pasur dhunë, por ndaj meje jo.

*Kur ju merrnin në pyetje? Natën?*  
– Kryesisht natën. Nga ora dymbëdhjetë.

*A mbani mend ndonjë emër të hetuesve?*  
– Po, si jo. Ishte Çanoviçiq. Ky ishte hetues për mua. Ka qenë edhe një Çaloviçiq.

*A keni dyshuar ndonjëherë se kush ju zbuloi, nga rrodhi?*  
– Jo. Me siguri nuk di asgjë.

*Sa veta keni dalë në gjyq?*  
– Më duket nja nëntë veta në Prishtinë dhe në Gjiilan 7-8 veta. Gjykatës ka qenë Tahir Ibrani.



Prof. KADRI HALIMI  
(etnolog)  
(1921 - 2001)

Ishte prokuror Hasan Kryeziu, por nuk e lejuan dhe për ne u caktua një zëvendësprokuror, Ramo Vodopiçiq, boshnjak. E dija që ky në kohë të Shqipërisë ka bartur plis të bardhë.

*Ishte gjykim publik?*  
– Po, formalisht kanë qenë të gjitha gjykimet publike. Ishin të pranishëm edhe anëtarët e familjes. Gruaja ishte.

*Avokat a keni pasur?*  
– Ata i kanë caktuar. Ne nuk kemi marr avokat fare. Formalisht.

*A ka qenë serb avokati?*  
– Po, serb ka qenë!

*A ju mbronte ndopak apo fare?*  
– Jo, more, por vetëm sa për të thënë që është aty.

*A ju dërguan menjëherë në Nish?*  
– Gjykimi u bë në shtator, e ata na kanë shpërndarë në mars të viti vijues. Më së pari më kanë çuar në Mitrovicë të Sremit. E nga Mitrovica e Sremit në Pozharevc.

*A mbani mend ndonjë të burgosur politik që keni parë aty?*  
– Po. Kanë qenë Kadri Kusari, Adem Demaçi, Zeqir Gërvalla. Ka pasur edhe të tjerë, por kam harruar. Kemi qenë tetë a dhjetë shqiptarë aty. Aty kemi folur mes vete aq sa kemi pasur mundësi dhe tjetër bisedë nuk kishim, pos për punën tonë.

*Juve, çfarë pune ju dhanë aty në Pozharevc?*  
– Aty kam punuar në një punëtori mekanike, si shpues metali, gati dy vjet.

*Kur ju kanë ndarë ju të burgosurve politikë, a keni pasur në dhomë ndonjë shqiptar?*  
– Ka pasur shqiptarë plot, por aty në Pozharevc ne shqiptarëve na kanë bërë bashkë të gjithëve.

*Sa zgjati ajo kohë?*  
– Derisa e kemi mbaruar kohën e dënimit.

*A vërehej ndonjë urretje ndaj jush, si shqiptarë dhe të dënuar për politikë?*  
– Jo, jo. Pasi ra Rankoviçiqi, që zbutur situata.

*Vizitat nga familja ishin në çdo muaj?*  
– Po, po.

*Vinte për vizitë shoqja, nëna?*  
– Po. Nëna, shoqja, çika, djali. Na kanë sjellë pako, deri 16 kg në muaj.

*Kur e keni përfunduar burgun?*  
– Në vitin 1968. Kam dalë bash në kohën e demonstratave. Kam dalë pak para demonstratave të vitit 1968 që u bënë më 27 e 28 nëntor të '68-tës.

*Kush mbeti në burg kur dolët ju?*  
– Ademi, edhe Kadri Kusari, Zeqir Gërvalla, Xhafer Mahmuxhiku, Hysen Daci.

*Në dënimin e dytë, sa vjet burg mbajtët?*  
– Shtatë vjet e gjysmë.

*A i përjetuat mirë demonstratat që po bëheshin?*  
– Po, ishim të kënaqur.

*A ndodhi t'ju marrin në pyetje prapë, pasi kishit dalë nga burgu?*  
– Jo, nuk kanë ardhur.

*Sa kohë keni ndenjur pa punë?*  
– Nja një vit apo një vit e gjysmë, ashtu. Nuk më linin as në arsim, as në kulturë, as në shkencë. Më morën përktues, referent në Spitalin e Përgjithshëm. Aty kam punuar katër vjet. Më dhanë këtë banesë, që kam tash. Pastaj dola në pension. Sa herë flisnim diçka, dilte problem. Kështu, mjekët shqiptarë, pasi ka qenë një konsilium për të caktuar shëndetin për pensionim të parakohshëm, edhe kështu vepruan. Prej asaj dite isha në pension invalidor.

*A kishit akoma përcjellje apo provokime, si i burgosur politik?*  
– Jo, jo. Shqiptarët e kishin në dorë krejt punën.

*Sa ishit në punë në Spital, a jeni marrë me punën tuaj profesionale?*  
– Jo, jo.

*E pashë një foto në librin tuaj nga Karadaku?*  
– Tash e kam botuar atë libër. Në libër kam trajtuar shumë tradita tona. Kam trajtuar edhe pozitën e gruas në familje. Kam përgatitur edhe një libër tjetër për botim.

*E keni imagjinuar ndonjëherë këtë që ndodhi këtu te ne në këtë kohë?*  
– Jo, asnjëherë.

*Si po ju duket kjo gjendje faktike e popullit shqiptar, në Kosovë e në Shqipëri?*  
– Mirë, por punët po shkojnë fort ngadalë. Neve po na ngutet. Erdhën në pushtet shqiptarët. Pse të mbetet Mitrovica ashtu? Duhet të veprohët menjëherë.

*Po thonë se nëse hiqen edhe ata serbë, mbetet Kosova etnikisht e pastër?*  
– Ka disa katunde në anën e Moravës, Ranillugu, Ropotova...

*56 fshatra i ka Gjilani, apo? Ka serbë edhe Kamenica, edhe Graçanica?*  
– Po ta marrin pushtetin në dorë shqiptarët, serbët ikin menjëherë. Serbët nuk i durojnë shqiptarët në pushtet.

*A ishit këtu në Prishtinë, kur u suprimua autonomia?*  
– Po, isha këtu në Prishtinë.

*Po do shqiptarë edhe patën ngritur gishtat!? Thuhet se para votimit i ka thirrur UDB-a dhe i ka përpunuar?*  
– Sigurisht, i ka ftuar dhe i ka kërcënuar.





**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## FFK-ja nënshkruan memorandum bashkëpunimi me komunën e Prizrenit

**PRISHTINË, 10 JANAR** - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, bashkë me ushtruesin e detyrës së sekretarit të përgjithshëm, Taulant Hodaj, të martën pritën në takim kryetarin e komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, bashkë me nënkryetarin Kujtim Gashi.

Qëllimi i këtij takimi ishte memorandum i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe konkretizimi i projekteve, i cili u nënshkrua nga presidenti Ademi dhe i pari i qytetit të Prizrenit, Totaj. Kjo marrëveshje përfshin realizimin e projekteve

të cilat paraprakisht janë dakorduar dhe do të jetësohen me investimet e të dyja palëve, me ç'rast komuna do të merret me bazën e investimeve në stadiumet e futbollit, derisa FFK-ja me pjesën sportive. Çdo projekt i paraparë në memorandum do të punohet

në bazë të standardeve të UEFA-s dhe FIFA-s. Nga ky memorandum i bashkëpunimit, ku prioritet do të jetë infrastruktura sportive e futbollit, do të përfitojnë klubet e futbollit të rajonit të Prizrenit dhe komuniteti i gjerë i futbollit.



## Ermal Krasniqi nga Ballkani kalon te CFR Cluj

Futbollisti Ermal Krasniqi, që ishte pjesë edhe e Përfaqësueses së Kosovës, ka realizuar transferimin e madh nga skuadra e Ballkanit te CFR Cluj. Klubi rumun është shprehur i kënaqur me marrëveshjen e arritur, e cila i ka kushtuar 400 mijë euro. Klubi kampion i Kosovës e falënderon për kontributin e madh dhe i uron suksese në të ardhmen

**EPOKA ERE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 10 JANAR** - Futbollisti Ermal Krasniqi ka bërë një hap të madh në karrierën futbollistike, pasi e ka kompletuar transferimin me klubin e madh nga Rumania, CFR Cluj. Prezantimi i Krasniqit nga skuadra rumune u bë të martën. "Mirë se erdhe, Ermal Krasniqi! Mesfushori ofensivë 24-vjeçar ka evoluar në tre sezonet e gjysmë të fundit te FC Ballkani, skuadër për të cilën ka bërë 105 paraqitje. Me fanellën e kampionit të Kosovës, Krasniqi ka shënuar 39 gola dhe ka dhënë 17 asistime", thuhet në njoftimin e klubit

rumun. Pas realizimit të këtij transferimi, Ballkani ka reaguar duke vlerësuar lart kontributin e Krasniqit në klub dhe rrugëtimin drejt sukseseve historike që i ka arritur duke u shpallur kampion i Kosovës dhe më pas arriti kualifikimin në fazën e grupeve në Ligën e Konferencës. Klubi nga Suhareka konsideron se futbollisti në fjalë do të mbetet gjithmonë i skalitur në klubin kampion. "Faleminderit për kontributin kampioni ynë, Ermal Krasniqi! Sot u kompletua transferimi i tashmë ish-lojtarit tonë, Krasniqit, në klubin rumun CFR Cluj. Krasniqi ishte pjesë e jona që nga viti 2019, duke mbajtur

barrën e ekipit së bashku me shumë lojtarë të ekipit dhe në sezonin 2021/2022 ishte një prej shumë lojtarëve të klubit që e arritën suksesin e titullit kampion i Superligës së Kosovës. Ai vazhdoi duke shkruar histori në futbollin kosovar me pjesëmarrjen në garat evropiane dhe, së fundmi, e veshi edhe fanellën e Përfaqësueses së Kosovës. Emri i tij do të mbetet gjithmonë i skalitur në klubin tonë. FC Ballkani të dëshiron shumë shëndet dhe suksese në karrierë!", thuhet në njoftimin e Ballkanit. Krasniqi ka nënshkruar deri më 30 qershor të vitit 2026 derisa, sipas "Transfermarkt", Klubit të CFR Cluj i ka kushtuar 400 mijë euro.



## Sonte derbi i rivaleve të vjetra Prishtina - Peja

**PRISHTINË, 10 JANAR** - Në mesjavë, përkatësisht të mërkurën (sot), do të zhvillohen dy ndeshje të mbetura në Prince Caffè Superligën e Kosovës në basketboll. Në kryeqytet do të përballen Sigal Prishtina dhe Peja, dy rivalët e vjetra në basketbollin e Kosovës, në sfidën e mbetur të xhiros së 15.

Prishtinasit kanë 11 fitore e pesë humbje, kurse pejanët 12 fitore e katër humbje, andaj pritet një takim shumë interesant. Kjo ndeshje do të zhvillohet pa praninë e tifozëve. Nesër do të zhvillohet edhe përballja mes Golden Eagle Yllit dhe Ponte Prizrenit në kuadër të xhiros së 11. Ylli është në një

formë të jashtëzakonshme me 11 fitore pas katër humbjeve që kishte në fillim, kurse prizrenasit kanë gjashtë fitore dhe dhjetë humbje.

**TË MËRKURËN TAKOHEN:**  
17:00 Golden Eagle Ylli - Ponte Prizreni (Java 11)  
19:00 Sigal Prishtina - Peja (Java 15)

## Davis, MVP i javës së 17

**PRISHTINË, 10 JANAR** - Në xhiron e 17 u zhvilluan disa ndeshje interesante. Derbin e fitoi Golden Eagle Ylli ndaj Pejës në udhëtim. Basketbollisti më i mirë i ndeshjes ishte Rashun Davis me 24 pikë, tri kërcime e shtatë asistime. Ai ishte i saktë 3/5 për tri pikë, 6/7 për dy pikë dhe 3/5 nga gjuajtje

e lira. Rashun ishte basketbollisti më i mirë i ndeshjes dhe i kësaj xhiroje. Trepça shënoi fitore të pritur në udhëtim ndaj Rahovecit, ku u dallua qendra Andrew Gordon me 22 pikë, 12 kërcime dhe një asistim, si dhe Mikaille Tmusiq me 13 pikë, nëntë kërcime dhe tri asistime. Dustin Thomas

### TOP PESËSHJA

**Rashun Davis (Golden Eagle Ylli) 24 pikë, 3 kërcime, 7 asistime**  
**Andrew Gordon (Trepça) 22 pikë, 12 kërcime, 1 asistim**  
**Dustin Thomas (Sigal Prishtina) 25 pikë, 4 kërcime, 2 asistime**  
**Fisnik Rugova (Bashkimi) 19 pikë, 6 kërcime**  
**Mikaile Tmusiq (Trepça) 13 pikë, 9 kërcime, 3 asistime**

sërisht u dallua te Sigal Prishtina, që mundi Vëllaznimin. Thomas ndaj kuqezinjve kishte 25 pikë,

katër kërcime dhe dy asistime. Ndërkohë, derbin prizrenas e fitoi Bashkimi, ku më i miri në parket në



çastet vendimtare ishte Fisnik Rugova me 19 pikë e gjashtë kërcime, duke hyrë në top 5 të kësaj jave.

## Chelsea i kushton 11 milionë euro huazimi i Felixit

LONDËR, 10 DHJETOR - Futbollisti portugez Joao Felix mund të llogaritet nga tani futbollist i Chelsea. Fabrizio Romano, që njihet ekspert i transferimeve, tashmë është arritur edhe marrëveshja e plotë verbale.

Felixa do të huazohet te Chelsea për pjesën e mbetur të sezonit, teksa "bluve" ky huazim do t'u kushtojë 11 milionë euro, me pagë 100 % të mbuluar nga klubi londinez. Në marrëveshje nuk do të

përfshihet asnjë opsion blerjeje dhe sulmuesi portugez do të rikthehet në Madrid pas përfundimit të sezonit. Para se të largohet tani nga "Wanda Metropolitano", 23-vjeçari do ta rinovojë kontratën me

Atleticon deri në vitin 2027. Felix do të fluturojë për në Londër në orët e ardhshme për t'iu nënshtruar testeve mjekësore dhe për ta nënshkruar pastaj kontratën me Chelsea.



## Sylvinho fillon punën te Shqipëria, takohet me të gjithë trajnerët e ekipeve kombëtare

TIRANË, 10 JANAR - Trajneri i ri i Kombëtares së Shqipërisë, Sylvinho, ka nisur punën pasi mori zyrtarisht detyrën të hënën. Braziliani së bashku me dy ndihmës-trajnerët e tij, Pablo Zabaleta dhe Dorival Guidoni Junior, kanë zhvilluar një takim me të gjithë trajnerët e ekipeve kombëtare të moshave, për djem dhe vajza, ka njoftuar Federata Shqiptare e Futbollit. Në këtë takim ishin të pranishëm trajneri i Kombëtares së vajzave, Armir Grima, trajneri i Kombëtares U-21, Alban Bushi, trajneri i Kombëtares U-19, Armando Cungu, trajneri i Kombëtares U-18, Ardi Behari, trajneri i Kombëtares U-17, Ervin Bulku, trajneri i Kombëtares U-16, Agron Kërçova, trajneri i Kombëtares U-15, Armand Damo, trajneri i Kombëtares U-19 për vajza, Kreshnik Krepi, trajneri i Kombëtares U-17, për vajza, Agustin Kola si edhe drejtori i Departamentit të Ekipeve Kombëtare në FSHE, Dritan Babamusta dhe menaxheri Denis Lilo. Pas prezantimit, trajneri Sylvinho



shprehu optimizëm për këtë bashkëpunim të ri dhe shfaqti entuziazmin e tij për këtë aventura të re me Shqipërinë. Braziliani theksoi se bashkëpunimi mes trajnerëve të ekipeve kombëtare të moshave dhe Kombëtares A do të jetë shumë i ngushtë për të përgatitur dhe për të afirmuar sa më shumë lojtarë të talentuar. Gjithashtu, Sylvinho u njoh edhe me mënyrën e organizimit të të gjitha ekipeve të të moshave dhe për programin apo metodologjitë stërvitore që ato aplikojnë gjatë vitit teksa mori

informacion edhe për mënyrën se si monitorohen elementët e spikatur të cilët aktivizohen veçanërisht jashtë vendit. Trajneri i "kuqezinjve" theksoi se qëllimi i përbashkët është i njëjtë, për të afirmuar sa më shumë futbollistë të rinj, por edhe për të marrë sa më shumë rezultate pozitive me të gjitha ekipet kombëtare të moshave. FSHF-ja njoftoi gjithashtu se takime të ngjashme do të jenë periodike në një kohë që stafi i ri teknik përgatitet për nisjen e eliminatorëve të Evropianit Gjermani 2024 në muajin mars.

## Denveri ruan kreun në Perëndim, Bostoni kryeson në Lindje

BOSTON, 10 JANAR - Denver Nuggets mbron kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 122-109 ndaj Lakersave, që ndalen pas pesë fitoresh radhazi. Mungesa e Jamesit dhe Davisit ndikuan për lakersat, ndërkohë që për Denverin u dallua Murray me 34 pikë. Ritmin e Denverit e ruan edhe Memphisin, që mundi me rezultat 121-113 San Antonion,



sfidë ku u dallua Tyus Jones me 24 pikë. Në Lindje vijon të dominojë skuadra e Bostonit, që mundi me rezultat 107-99 Chicagon, ndeshje me rivalitet. Tatum me 32 pikë bëri dallimin në fushë, mbështetur edhe nga Williamsi me 20 pikë.

Rikthehet te fitorja Milwaukee, që mundi New Yorkun (111-107), ndeshje ku u dallua Giannis me 22 pikë e 10 rebounde, ndërsa Sacramento, falë 30 pikëve të Barnesit, mundi Orlandon (136-111).

### REZULTATET

Washington - New Orleans	112-132
Boston - Chicago	107-99
New York - Milwaukee	107-111
Memphis - San Antonio	121-113
Denver - Lakers	122-109
Sacramento - Orlando	136-111

## Llorisi pensionohet nga Kombëtarja e Francës

Portieri Hugo Lloris ka njoftuar tërheqjen nga Kombëtarja e Argjentinës në moshën 36-vjeçare. "Vjen një moment kur duhet të dish t'i dorëzosh frenat.

Gjithmonë kam thënë vazhdimisht se skuadra franceze nuk i përket askujt dhe ne të gjithë duhet të sigurohemi që të jetë kështu. Unë së pari. Mendoj

se skuadra është gati për të vazhduar. Ka edhe një portier që është gati, Mike Maignan", ka deklaruar Lloris. Karriera me kombëtaren e Francës e Lloris u

shtri nga viti 2008 deri më 2022 dhe e pa atë të luajë në katër Kupa Bote dhe tre turnirë të Kampionatit Evropian. Ai i udhëhoqi ata drejt lavdisë

botërore në Rusi në vitin 2018 përpara se skuadra e tij të dështonte katër vjet më vonë, duke humbur 4-2 në penallti kundër Argjentinës së Leo Messit.

### SHKURT

#### KB Trepça përforcohet me një amerikan

KB Trepça ka njoftuar zyrtarisht për arritjen e marrëveshjes me basketbollistin Will Daniels. Amerikani i gjatë 203 centimetra luan në pozitën e krah-qendrës. Daniels në "Minatori" kalon pas një aventure te Nacionali në Uruguai. 36-vjeçari karrierën e ka zhvilluar edhe në Greqi, Francë, Turqi e Izrael. Will Daniels do ta zëvendësojë amerikanin tjetër Cadarian Raines, me të cilin Trepça e ndërpreu bashkëpunimin ditë më parë.

#### Hamiltoni: Jam i motivuar për suksese të reja

Në fund të këtij viti skadon kontrata e Lewis Hamiltonit me Mercedesin. Ende nuk dihet nëse piloti britanik, shtatë herë kampion bote në Formula 1, do të qëndrojë me makinën gjermane apo do të largohet. Ai që ka dhënë një përgjigje për këtë çështje është vetë Hamiltoni. "Mendoj se çdo vit një pilot pyet veten nëse është në gjendje ta japë maksimumin në pistë apo jo. Madje të japë më shumë se një vit më parë. Nëse do të arrija në atë pikë, që nuk do të kisha motivim, nuk do të stërvitesha e nuk do ta jepja maksimumin, do të largohesha", ka thënë Hamiltoni. "Kemi një sezon të vështirë përpara, ku garojmë për të rikuperuar, ndaj jam i motivuar. Kjo do të thotë se dëshiroj të vazhdoj të garoj për sa kohë që jam i motivuar. Ne arritëm të jemi të bashkuar në një moment të vështirë dhe u rikthyem te suksesi. Shpresoj që kjo sfidë t'ia vlejë për këtë vit", ka shtuar Hamiltoni.

#### Halleri: Tifozët janë motivi im

Sebastien Haller është rikthyer në stërvitje me ekipin e Borussia Dortmundit. Sulmuesi u diagnostifikua me tumor në testikuj para disa muajsh, duke u përballur kështu me një sfidë mjaft të madhe, të cilën 28-vjeçari e fitoi. "Tani kuptoj se ajo që kam kaluar në muajt e fundit më ka bërë të kuptoj shumë gjëra. Kam kaluar momente vërtet të vështira, sidomos kur takoja edhe njerëz të tjerë në spital të cilët në atë moment ishin më mirë se unë. Kjo më jepte shpresë për të ardhmen dhe flisja me njerëz që kishin të njëjtën sëmundje si unë. Secili kishte problemin e tij, por shkëmbenim shumë këshilla të vlefshme. Që nga momenti i parë objekti im ishte të rikthehesha në fushë dhe të luaja sërish para 'Murit të Verdhë'. Tifozët janë motivi për të cilin çdo lojtar zbret në fushë dhe kur kjo të ndodhë, dua të jem gati", ka shkruar Halleri.

#### Nice shkarkon trajnerin Favre

Skuadra Nice ka shkarkuar Lucien Favre nga posti i trajnerit të skuadrës. Ky vendim është marrë nga drejtuesit e skuadrës pas eliminimit nga Kupa e Francës. Në 1/32 e finales ekipi i Favre humbi nga një ekip i ligës së tretë "Le Puy Foot" me rezultat 0-1. 65-vjeçari ka qenë trajner i Nices që nga korriku i vitit 2022. Pas 17 javësh, Nice është në vendin e 11 në renditjen e Ligës 1 me 21 pikë. Ndeshjen e radhës Nice do ta luajë kundër Montpellierit më 11 janar.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 29.08.2022 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 11.01.2023 të rishpall:

### KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

**Një (1) Inkasant/Arkëtar** -Njësia në Mitrovicë me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

#### Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Bëne inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat ngarkohet materijalisht;
- Bënë zbulimin - regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të përgjithshme ;
- Përcjell ndryshimet apo ndërrimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera të nevojshme në sektorin e amvisërisë respektivisht komercial duke e njoftuar Shërbimin e faturimit;
- Dorzimin ditor të pazarit nga faturat e inkasuara;
- Përgjegjësi materiale dhe penale për faturat e inkasuara si dhe përgjegjësi në punë;
- Realizimi i normativit të inkasimit i përcaktuar sipas planit të punëdhënësit;
- Kryen edhe punë të tjera të kësaj natyre sipas urdhërësës së eprorit të dretpërdrejtë;

#### Kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën e shkollës mesme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

#### Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 11.01.2023 deri më datën 25.01.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Dua Produkt" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811938797 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Dua Produkt" D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811938797 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Dua Produkt" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811938797 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

### FTESË PËR OFERTË

**Lloji i Kontratës:**  Furnizim  Shërbime  Punë

Nr. i Prokurimit 01-23

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtarëve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-privatë, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në **adresën Institutit A, Kati 2, QKUK, 10 000 Prishtinë, apo përmes emailit: info@omk-rks.org, me titullin:**

**Dosja për: Kontratë për furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative të OMK-së**

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

#### Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **18.01.2023 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **20.01.2023 ora 12:00.**

Hapja e ofertave bëhet me datën: **20.01.2023 ora 14:00.**

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Xhelal Veseli shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Fadil Bytyqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfm "Abdyl Frasheri" Prizren.

► Fadil Bytyqi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

► Valdim Bytyqi shpall të pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Befasim Bytyqi shpall të pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Besmir Kusari nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Mjekësisë "Hysni Zajmi".

► Hasan Ethemi nga Smaqi i Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë nga klasa e -I- deri në klasën e -VIII-, të Sh.F. "Shaban Gola", Lipovec, Gjakovë.

► Ryve Nivokazi nga Nivokazi i Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. "Jahë Salihu", Molliq.

► Merita Kastrati nga Prizreni shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së -I,II,III,IV dhe diplomën e SH.M. Mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë.

► Avni Ramaj nga Shaptej shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së -X- të shkollës së mesme ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

► Shahander Binxhia nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

► Vjollca Bytyqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M. Ekonomike "Kadri Kusari", Gjakovë.

► Avni Ramaj nga Shaptej, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës -XI,XII,XIII- të shkollës SH.M.T. "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

► Ardi Duraku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

► Shkodran Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.Mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë.

Kujtim Kameri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës së -X,XI,XII- të shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

